



Pranimi Pranimi No.	Interpretimi Pranimi No.	24 - 08	2022	2	viti god vepr.
Organ Mbrojtja Organ Shërbimi Org. Titull	Id. Pror. Id. Pror. Id. No.		Shtesa Pufteg Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPM/SJK	4944/2022			1/4	



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.626/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.626/2022 të datës 18.07.2022, të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ me adresë \_\_\_\_\_

kundër organit të punësimit Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 24.08.2022, mori këtë:

### V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.626/2022 e datës 18.07.2022 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_

II. Mbetet në fuqi Vendimi i datës 29.06.2022 i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës.

### A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës, duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafit 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht me datën 29.04.2022 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 01.06.2022 ka shpallur konkursin e jashtëm për grupin e pozitave Specialist i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës.

Menaxheri i Personelit në Komunën e Gjakovës, me datën 23.06.2022 ka nxjerrë Vendimin, sipas të cilit ankuesit i është refuzuar aplikimi në konkursin për grupin Specialiste i bujqësisë,



pyjeve dhe tokës, me arsyetimin se dëshmitë lidhur me përvojën e punës duhet të jenë vërtetime apo referenca që përmbajnë datën e fillimit dhe përfundimit të marrëdhënies së punës, pozitën e punës dhe elemente tjera.

Ankuesi i pakënaqur me mos përfshirjen në listën e ngushtë, brenda afateve ligjore ka parashtruar ankesë tek Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës. Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës, me datën 29.06.2022 ka nxjerrë Vendim sipas të cilit i ka refuzuar ankesën e ankuesit, me arsyetimin se i njëjti nuk ka prezantuar asnjë dëshmi valide në raport me përvojën e tij të punës.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin lidhur me refuzimin e ankesës nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Gjakovës, me datën 18.07.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 4159/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 21.07.2022, ka proceduar kërkesën me numër të protokollit 4220/2022 për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjakovës, ndërsa me datën 05.08.2022 përmes shkresës me numër protokollit 4549/2022, Komuna e Gjakovës ka kthyer përgjigjen në ankesën e ankuesit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.Prot:4159/2022 të datës 18.07.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 29.06.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës lidhur me refuzimin e ankesës së ankuesit; Pasqyrën e llogarisë së trustit për ankuesin për periudhën prej 11.12.2004-24.06.2022; Vendimin e datës 23.06.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës lidhur me refuzimin e aplikacionit të ankuesit; Shkresën zyrtare të datës 24.09.2021 nga Komuna e Gjakovës; Provat shtesë të datës 29.07.2022 nga ana e ankuesit në Këshill; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 21.07.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 05.08.2022 nga Komuna e Gjakovës lidhur me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Konkursin e datës 01.06.2022 me numër RN00002648; Aplikacionin e ankuesit me numër të referencës RN00008886 së datës 01.06.2022 së bashku me dëshminë mbi përvojën e punës dhe atë profesionale; Listën e aplikantëve me numër RN00008886; Dokumentin e verifikimit paraprak me numër RN00008886 të datës 23.06.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës; Ankesën e ankuesit e parashtruar tek në sistem lidhur me refuzimin e aplikacionit nga ana e Zyrës së Burimeve Njerëzore e Komunës së Gjakovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit duke ju referuar shkresave të lëndës gjegjësisht, Konkursit me numër RN00008886, të datës 01.06.2022 ka konstatuar se kriteret e konkursit për grupin "Specialistë i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës" në Komunën e Gjakovës, kanë qenë:



- *Diplomë të studimeve universitare, në Bujqësi ose Agrobiznes me të paktën 180 kredi /ECTS apo ekuivalente me to;*
- *Së paku dy (2) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Sipas shkresave të administruara të lëndës rezulton se ankuesi në aplikacionin e tij me numër të referencës RN00008886 të datës 01.06.2022 lidhur me pozitën e punës për grupin "Specialistë i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës" në Komunën e Gjakovës, ka deklaruar se ka punuar për periudhën prej 01.01.1989-01.12.1992 tek Radoniqi në pozitën si "Këshilltar për fermer", prej 01.07.1999-01.08.2001 tek Solidarities në pozitën "Oficer i lartë në teren" si dhe prej 01.12.2001-01.12.2004 tek NGO Bergamo për il Kosovo-Italy në pozitën e punës "Inxhinier i bujqësisë", ndërsa si dëshmi të përvojës së punës në aplikacionin e tij ka bashkangjitur Letër referencën e datës 13.09.2000 nga Solidarities Aide Humanitaire Durgence, Letër referencën e datës 18.08.2003 nga Pro.DO.CS Progetto Domani Cultura e Solidarieta, Referencën e datës 15.01.2007 nga Sogreah Kosovo-Europe Aid/119578/D/SV/KOS.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ndërlidhur me përvojën e punës së ankuesit ka analizuar dispozitat e nenit 12 paragrafin 2 nën paragrafin 2.3 të Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: "*Kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurimit dhe të deklaruara në aplikacion*" dhe ka konstatuar se i njëjti me rastin e aplikimit për pozitën e lartcekur, nuk ka paraqitur dëshmitë lidhur me vërtetimet nga përvoja e punës të institucionit përkatës, mbi të cilat dëshmohet saktë periudha e përvojës së punës, pozita të cilën e ka mbajtur dhe për çfarë periudhe kohore ka punuar në atë pozitë, kohëzgjatja në pozitën e caktuar dhe arsyet e shpalljes së marrëdhënies së punës nga ajo pozitë, mirëpo si dëshmi për përvojën e punës ankuesi ka dorëzuar vetëm letër referenca, gjë që për Kolegjin ka qenë e pamundur të vërtetoj saktë periudhën kohore të punës së ankuesit lidhur me pozitën të cilat i ka mbajtur tek institucionet përkatëse dhe periudhën kohore se sa ka punuar, poashtu ankuesi me rastin e dorëzimit të ankesës në këshill ka dorëzuar edhe dokumentin/trustin pensional ndërsa sipas shkresave zyrtare të dërguar nga organi i punësimit të njëjtin dokument nuk e ka dorëzuar edhe te organi i punësimit përkundër që edhe sipas këtij dokumenti nuk mund të vërtetohet saktë përvoja e punës në fushën në të cilën zhvillohet procedura sipas këtij konkursi, e krejt kjo në kundërshtim me dispozitën e lart cekur. Prandaj pas konstatimit të këtyre fakteve, Kolegji vlerëson se ankuesi bazuar në dëshmitë të cilat i ka paraqitur me rastin e aplikimit nuk ka arritur të dëshmoj përvojën e punës prej dy (2) vitesh ashtu siç është kërkuar me konkurs.

Andaj, bazuar në faktet e lartë përmendura me sipër, konstatohet se Njësia Përgjegjëse, gjegjësisht Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Gjakovës me rastin e nxjerrjes së Vendimeve të datës 23.06.2022, ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë ligjin material duke vepruar kështu në përputhje me nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.



Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të provave të bashkëngjitura të lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.626/2022, datë 24.08.2022.

**Ardita Perçuku-Shyti**



Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



**Vendimi i dorëzohet:**

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryetarit të Komunës së Gjakovës;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjakovës;
- ❖ Arkivit të KPMSHCK- së.